

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE KONTRATES

1. Përcaktime të Përgjithshme.

Kompania e sigurimit "ALBSIG" sh.a. këtu e në vazhdim, do të quhet **Siguruesi**.

I Siguruari ose Kontraktuesi, këtu e në vazhdim do të quhet subjekti fizik ose juridik, pjesmarrës në një tender prokurimi, i cili është shpallur fitues nga Autoriteti Prokurues, publik ose jo.

Përfituesi, këtu e në vazhdim do të quhet, Autoritet Prokurues që organizon procesin e tenderimit.

2. Objekti i Sigurimit.

Objekti i kësaj kontrate sigurimi është marrëdhënia e juridike në të cilën:

1. Siguruesi garanton Përfituesin për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së prokurimit të nënshkruar ndërmjet palëve në përputhje me dokumentat e tenderit;
2. I Siguruari detyrohet t'i kthejë Siguruesit çdo vlerë monetare të paguar prej tij në rast të ekzekutimit të garancisë siç përcaktohet në Pikën 1, të këtij neni.

3. Vlefshmëria e Kontratës

3.1 Vlefshmëria e kësaj kontrate sigurimi fillon datën e nënshkrimit të kontratës së prokurimit nga palët në përputhje me dokumentat e tenderit, ose ate te shenuar ne Formular dhe mbaron me zbatimin e plotë të saj, në ditën e lëshimit të Çertifikatës së Mbarimit të Punimeve nga Përfituesi, por ne çdo rast jo me vone se data e shenuar ne Formular per perfundimin e saj. Vlefshmëria e këtij sigurimi në lidhje me pikën 2 të Nenit 2 shtrihet deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të të Siguararit ndaj Siguruesit.

3.2 Formulari i sigurimit të Kontratës është i vlefshëm vetëm kur është i shoqëruar me këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit të Kontratës, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar, në të kundërt Formulari i Sigurimit të Kontratës është i pavlefshëm.

4. Shuma e Sigurimit ose Garancisë.

4.1 Shuma e sigurimit shënohet në formularin e sigurimit të kontratës dhe përbën nivelin maksimal të detyrimit të Siguruesit ndaj Përfituesit dhe të të Siguararit ndaj Siguruesit në

Bashkelidhur Form. Sig. Kontrates no.

rastin e parashikuar në Pikën 2 të Nenit 2, të kësaj Kontrate.

4.2 Çdo rritje e mundshme e shumës së sigurimit të përcaktuar në Formularin e Sigurimit të Kontratës do të bëhet me miratimin e Siguruesit, kundrejt paraqitjes së një kerkese për këtë shtesë nga Përfituesi. Në rast se Siguruesi miraton rritjen e shumës fillestare të sigurimit, i Siguruari duhet të paguajë primin shtesë përkatës dhe të pajiset me një formular të ri të sigurimit të kontratës.

5. Primi i Sigurimit.

Pagesa e primit të sigurimit kryhet pranë Deges ose agjencise së Siguruesit ku lëshohet Polica e Sigurimit. Pagesa e primit konsiderohet e kryer në momentin e kalimit të vlerës së tij, në llogarine e Siguruesit.

6. Ekzekutimi i detyrimeve.

6.1 Siguruesi paguan shumen e garantuar brenda 15 ditëve nga mbërritja e kërkeses me shkrim nga Përfituesi, me kusht që në shkresë të jetë përcaktuar mosrealizimi i detyrimit kontraktor dhe vlera përkatëse e këtij mosrealizimi. Kundrejt kërkesës së Siguruesit palët duhet të paraqesin një kopje të kontratës së prokurimit të nënshkruar prej tyre. Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit (mos realizimit). Në rast mos respektimi të këtij afati Siguruesi ka të drejtë të vendosë për pagesën ose jo të shumes se garantuar.

6.2 I Siguruari është i detyruari dhe përgjegjësi kryesor për realizimin e kontratës së prokurimit të lidhur me Përfituesin. I Siguruari me marrjen e dokumentit të kryerjes së pagesës nga Siguruesi në favor të Përfituesit detyrohet të rimbursojë Siguruesin brenda 7 ditëve, për vleren e pagesës së kryer. Për vonesen tej këtij afati i Siguruari do të paguaj një penalitet prej 0,1 % në ditë të shumës së papaguar, si dhe të çdo shume ligjore tjetër të shpenzuar për arketimin e detyrimit kryesor.

7. Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Në rast mosmarreveshjes, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.